



Datë: 08.12.2025

Numër Protokolli: 7783/2025

A.nr.1898/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1898/2025, të datës 12.11.2025, të parashtruar nga ankuesi G.Q, kundër organit të punësimit: Ministra e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 08.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1898/2025, të datës 12.11.2025, të parashtruar nga ankuesi G.Q.

II. Pala ankuese udhëzohet mbi të drejtën e inicimit të kontestit juridik-civil pranë gjykatës kompetente.

A r s y e t i m

Ankuesi G.Q (tutje referuar vetëm ankuesi), më datë 12.11.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër të organit të punësimit lidhur me kërkesat e parashtruar më datë 08.01.2025, të përsëritura më datë 25.09.2025, përkitazi më mos kompensimin e pushimit vjetor të pashfrytëzuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të pashtuara nga palët në procedurë vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë **nuk është kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e lakuesit të datës 12.11.2025, *sepse:*

Ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokolli 40 të datës 21.10.2013, ka qenë i punësuar në pozitën *Zyrtar i Larte i Pagave* në Ministrinë e Administratës Publike i cili sipas memorandumit për bashkëpunim për bartjen e divizionit të pagave të Ministrisë së Administratës Publike i njëjti ka kaluar në Ministrinë e Financave përkatësisht në Thesarin e Kosovës i cili ka mbajtur të njëjtën pozite deri në përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të pensionimit.

Tutje, ankuesi më datë 08.01.2025 përmes kërkesës me numër protokolli 53, i është drejtuar Drejtorit Përgjithshëm ne Thesarin e Kosovës me të kërkesë për kompensim e ditëve të pa shfrytëzuara te pushimit vjetor, të cilën kërkesë e ka përsëritur me datë 25.09.2025 te Udhëheqësja e Personelit ne Thesarin e Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nuk e ka shfrytëzuar pushimin vjetor apo një pjesë të pushimit me fajin punëdhënësit, dhe i njëjti kërkon që ti kompensohen me të holla ditët e pushimit vjetore te pashfrytëzuara gjithsejtë tridhjetë e katër dite (34) sipas dispozitave ligjore te Ligjit të Punës.

Rrjedhimisht, në kuptim të kompetencës materiale të Këshillit për vendosje lidhur me këtë çështje juridike-administrative, Kolegji fillimisht thekson faktin se ankuesi deri me datë 27.01.2025 kishte statusin e nëpunësi civil, ndërsa me datë 08.01.2025, dhe 25.09.2025 ka paraqitur kërkesë të organi i punësimit, lidhur me kompensimin e pushimit vjetor , ndërsa, me Vendimin Nr. 05/2025 të datës 24.01.2025 të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm në Thesarin e Kosovës, ankuesi është liruar nga shërbimi civil nga data 27.01.2025 për shkak të pensionimit, pra, nga kjo datë ankuesi, ka humbur statusin e nëpunësit civil.

Andaj, nisur nga përcaktimi ligjor sipas nenit 6, paragrafin 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, se Këshilli ka juridiksion që të shqyrtoj vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, dhe duke qenë se ankuesi më rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill më datë 12.11.2025, nuk ka pas statusin e nëpunësit aktiv civil, atëherë, mbi ekzistimin e kësaj rrethane ligjore Kolegji konstaton se Këshilli nuk është kompetent për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesën e ankuesit A.nr. 1898/2025, të datës 12.11.2025.

Si rrjedhojë, referuar pretendimeve ankimore të parashtruara si në ankesë, rezulton se në rastin konkret kemi të bëjmë më raport juridiko-civil, ashtu që, Kolegji i Këshillit lidhur më të drejtën e ankuesit në mjete juridike si e drejtë kushtetuese garantuar më Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejta e Njeriut (neni 13), udhëzon palën ankuese që drejtën e tij materiale të pretenduar si në ankesë ta realizoj në kontest civil në pajtim me dispozitat e Ligjit përkatës për Procedurën Kontestimore. Gjegjësisht, lënda nuk mund të bartet tek gjykata kompetente ngase në këtë fazë mungon padia si kusht kryesor për fillimin e një procesi gjyqësor.

Thënë si me sipër e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1898/2025

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit G.Q;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Thesarin e Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.